


# Kur dhe si duhet të paguani faturën e energjisë elektrike?



Ju keni detyrimin të paguani faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit .Pas kalimit të afatit 30 ditor, ju jeni të detyruar të paguani një kamatë vonesë të barabartë me 0.1 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera totale e vetë faturës.




Nëse ju nuk paguani faturën e energjise elektrike brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar , furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji.



Ju keni të drejtë të zgjedhni mënyrën e pagesës nëpërmjet zyrës së furnizuesit, bankave, zyrave postare, apo nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta nga llogaritë bankare.



Të gjitha pagesat e bëra nga ju duhet të përmbajnë të dhënat siç janë; numri i transfertës bankare, numri i llogarisë, dhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në faturën e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë numrin e kontratës, numrin e faturës dhe emrin tuaj.



Faturat e energjise elektrike dërgohen në adresën tuaj të përcaktuar në kontratë, dhe në rast kur ju vendosni të ndërtoni vendbanim pa njoftuar, atëherë jeni përgjegjës për mos pagesat e faturave të energjisë.

